



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 4 Maj 2011

RAPORT PARAPRAK

“MBI DISA NGA REZULTATET TË VEZHGIMEVE TË PROCESIT PARAZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET VENDORE, 8 MAJ 2011”

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), në mënyrë të vazhdueshme, qe nga viti 1996, ka vëzhguar si zgjedhjet parlamentare dhe ato locale sepse mbrojtja dhe respektimi i të drejtës së votës ka qënë dhe është pjesë e misionit të KSHH-së, si një nga të drejtat themelore të shtetasve, sanksionuar në Kushtetutën tonë.
2. Në kuadër të zgjedhjeve për pushtetin vendor të 8 Majit 2011 KSHH është angazhuar në vëzhgimin e ecurisë së procesit parazgjedhor në disa rrethe (përfshi qytetet dhe komunat), si në **Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Fier, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Kukës**¹.
3. **Objekt i këtij vëzhgimi ishin:** shpallja e listave paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve në afatin e përcaktuar nga ligji; vendosja e tyre në vende publike, të dukshme dhe të aksesueshme nga zgjedhësit; sensibilizimi i zgjedhësve për listat; ushtrimi i të drejtës së ankesës ndaj parregullsive në lista; vëzhgimi i elementëve të fushatës elektorale; ngritja e KZAZ-ve dhe trajnimi i tyre; ngritja e KQV-ve dhe trajnimi i anëtarëve të tyre.
4. Ky raport është formuluar duke mbajtur parasysh raportet e dërguara nga vëzhguesit e KSHH-së, të angazhuar në këtë proces parazgjedhor. Dëshërojmë të theksojmë se gjetjet janë të pjesshme, si pasojë nuk mund të arrihet në konkluzione të plota dhe të gjithanshme.

Nga monitorimi kanë rezultuar këto të dhëna:

5. **Fushata zgjedhore:** KSHH e filloi monitorimin në fillim të muajit Mars 2011, kur fushata zgjedhore, jo zyrtarisht kishte filluar. Fushata u shoqërua nga incidente të lehta dhe të rënda midis simpatizantëve dhe militantëve të

¹ Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasades së SH.B.A.-se në Tiranë dhe Civil Rights Defender (ish Komiteti Suedez i Helsinkit). Opinione, gjetjet, konkluzione dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

tre subjekteve kryesore: PD, PS dhe LSI. Incidentet, përplasjet, pa përjashtuar edhe ndonjë vepër kriminale. vazhdojnë megjithëse nga zgjedhjet na ndajnë edhe pak ditë. Atmosfera parazgjedhore është tensionuar². Ne nuk marrim përsipër të nxjerrim konkluzione për motivet e vërteta të këtyre incidentëve të dhunshme, sepse kjo është detyrë e organeve të drejtësisë por, mendojmë se kjo situatë është e influencuar edhe nga gjuha e urrejtjes, e përdorur nga liderët e partive politike, nga akuzat e ndërsjellta, nga mungesa e dialogut dhe e debatit konstruktiv midis tyre.

6. Incidentet e vazhdueshme mund të ndikojnë negativisht tek zgjedhësit të cilët kërkojnë një atmosferë të qetë. Nuk përjashtohet mundësia që klima e acaruar të reflektojë edhe në ditën e votimit. Që kjo të mos ndodhë nevojitet kontributi i të gjithë aktorëve, përfshirë këtu dhe median. Në këtë drejtim faktor I rëndësishëm janë, në veçanti, dy partitë e mëdha politike, megjithatë, duhet theksuar se është qeveria që mban përgjegjësinë kryesore për organizimin e zgjedhjeve, dhe në mënyrë të veçantë, për garantimin e rendit dhe të qetësisë gjatë gjithë fushatës.
7. KShH ka ndjekur me vëmendje edhe pasqyrimin e fushatës nga mediat e shkruara dhe ato elektronike. Pa anashkaluar punën e mëdhe të këtyre subjekteve për informimin e publikut gjatë kësaj fushate zgjedhore, do të nënvizojmë dy momente kritike: së pari: në fazën e shpalljes së listave paraprake dhe në atë të shpalljes së listave përfundimtare të zgjedhësve, mediat duhet të kishin patur më tepër në vëmendje sensibilizimin e zgjedhësve për t'u njohur me listat zgjedhore sepse ky dokumentacion është baza për ushtrimin e të drejtës së votës³; së dyti: Mediat kanë pasqyruar mirë aktivitetin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe komune por, nuk është bërë sa duhet për pasqyrimin e aktiviteteve të kryera nga kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiake dhe komunale. Mund të thuhet se zgjedhësit nuk janë njohur me emrat e këtyre kandidatëve, personalitetin dhe integritetin e tyre, ndërkohë që roli i këshillave dhe I këshilltarëve që I përbëjnë ato, është tepër i rëndësishëm sepse, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” këto organe janë të veshura me shumë kompetenca që lidhen me interesat e shtetasve dhe të grupeve të interesit.
8. Ngritja e KZAZ-ve: Nga monitorimet ka rezultuar se KZAZ-të u ngritën me vonesë për shkak se PS dhe PBDNJ nuk paraqitën në kohë propozimet e tyre. Konstitutimi i KZAZ-ve me vonesë shkaktoi, gjithashtu, fillimin me

² Për këtë KSHH ka reaguar nëpërmjet dy deklaratave publike, “Fushata zgjedhore me incidente acëron klimën e zgjedhjeve”, datë 15 Prill 2011; dhe “Të merren masa për parandalimin e konflikteve të mëtejshme gjatë fushatës zgjedhore”, datë 4 Prill 2011

³ Shih deklaratën e KSHH-së “Thirrje qytetarëve. Njohja me listat përfundimtare”, datë 12 Prill 2011



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vonesë të trajnimit të tyre, i cili ende nuk ka përfunduar. Nga ana tjetër u vërejt që disa KZAZ nuk kanë funksionuar rregullisht. Në mjaft raste selitë e tyre kanë qënë të mbyllura duke vështirësuar marrjen e informacionit nga vëzhguesit e KSHH-së lidhur me aspekte të administrimit të zgjedhjeve. Edhe për këtë, KSHH ka reaguar me deklaratë publike.

9. **Listat paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve:** Listat paraprake janë shpallur me vonesë. Veç kësaj njësitë e qeverisjes vendore nuk kryen njoftimin e zgjedhësve në banesat e tyre (sipas nenit 50 të Kodit Zgjedhor). Gjatë kësaj faze nuk u krye asnjë lloj sensibilizimi për zgjedhësit. Shumica e zgjedhësve, të cilët i kemi kontaktuar, nuk ishin njohur me listat paraprake të zgjedhësve. Nga informacionet e marra pranë njësive të pushtetit vendor, rezultoi se kërkesat për ndryshimin e emrave në listat paraprake ishin shumë të pakta.
10. Sipas monitorimit tonë në 710 qendra e votimi na rezultoi se listat përfundimtare të zgjedhësve jo vetëm u shpallën me vonesë, në pjesën më të madhe të tyre, por edhe kur u shpallën, në disa raste, u vendosën në vende të papërshtatshme dhe të paaksesueshme lehtësisht nga zgjedhësit. Listat përfundimtare të zgjedhësve janë vendosur shumë lart për t'u parë me sy të lirë, ose janë vendosur brenda ambjentëve publike, kryesisht arsimore, të cilat në orët e mbasdites ishin të mbyllura. U konstatuan edhe lista të dëmtuara dhe të grisura nga kushtet atmosferike ose persona keqbërës. Për këto problematika dhe çështje të tjera të evidentuara nga monitorimi, KSHH ka reaguar nëpërmjet deklaratave për shtyp⁴.
11. Problematike edhe aktualisht mbetet sensibilizimi i qytetarëve, i cili ka qënë i pakët, ndërkohë që sipas nenit 21 të Kodit zgjedhor, KQZ-ja merr masa dhe organizon programe për edukimin zgjedhor të shtetasve. Në këto rrethana KSHH i sugjeron medias elektronike dhe të shkruar që t'u bëjë thirrje zgjedhësve që të njihen, sa më parë, me listat zgjedhore dhe nëse nuk e gjejnë emrin në to, t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor⁵ për të patur mundësi të ushtrojnë të drejtën e votës. Bazuar në informacionet e vazhdueshme të vëzhguesve të KSHH, ka rezultuar që kërkesat e qytetarëve drejtuar gjykata të rretheve, deri më sot kanë qënë relativisht të pakta⁶, nëse i krahasojmë me zgjedhjet e kaluara.

⁴ Shih deklaratën e KSHH-së "Më tepër vemendje dhe kontroll për listat përfundimtare të zgjedhësve", Tiranë më 18 Prill 2011

⁵ Idem, si footnote 5

⁶ Në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë 27 kërkesa, në Durrës 88 (nga Paraburgimi Durrës), në Vlorë 24, në Shkodër 30, Elbasan 8, Kukës 3, Gjirokastër asnjë kërkesë, Fier 3 dhe Korçë 6 kërkesa.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

12. **Lidhur me Qëndrat e Votimit (KQV)**: 45 ditë para ditës së votimit, partitë politike duhet të paraqitnin propozimet e tyre për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve në KZAZ. Kjo dispozitë ligjore nuk u zbatua. Nga monitorimi i kryer në rreth 28 KZAZ deri në datën 20 Prill 2011, KQV-të nuk ishin ngritur në shumicën e tyre. Pothujse në të gjitha KZAZ-të është shkelur afati i fundit i përcaktuar për ngritjen e KQV nga Kodi Zgjedhor. Vonesa është shkaktuar sepse partitë politike nuk kanë bërë në kohë propozimet e tyre për anëtarë e sekretarë të KQV-ve. Veçanërisht shqetësuese paraqitet gjëndja në KZAZ nr. 40 të Bashkisë Shkodër, pasi deri disa ditë më parë (në 2 Maj) nuk ishte ngritur asnjë KQV, me pretendimin se propozimet e partive politike ishin paraqitur mbas datës 18 Prill 2011. Për këtë shkelje KSHH ka reaguar publikisht, nëpërmjet një deklarate për shtyp⁷, duke i sugjeruar si KZAZ-së në fjalë të veprojmë në mënyrë urgjente, përndryshe do të vihet në pikëpyetje trajnimi i anëtarëve dhe sekretarëve të këtyre komisioneve. Vlen të përmendet se detyra e anëtarëve të KQV-ve është e një rëndësie të veçantë. Si rrjedhim, qoftë edhe vetëm nga mungesa e njohurive për ushtrimin e funksionit, pasojat mund të jenë të tepër të dëmshme. KSHH do të vazhdojë të monitorojë ngritjen dhe trajnimin e KQV-ve deri në datën.7 maj 2011.

13. Vëzhguesit tanë na kanë informuar, gjithashtu, se një numër jo i vogël qendrash votimi janë vendosur në lokale private. Është e vërtetë që ligji këtë e lejon, por vetëm në raste të veçanta dhe vetëm me vendim të KQZ-së. Ka patur pretendime se disa nga këto qendra, si për shembull në Kamëz, janë vendosur në lokale private, pronarët e të cilëve kanë lidhje miqësore me këtë ose atë kandidat.

14. **Grupet e numërimit të votave** : Ky është një proces, të cilin sipas afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor kemi filluar ta monitorojmë nga dita e sotshme dhe do të vazhdojmë monitorimin deri në ngritjen dhe trajnimin të anëtarëve të tyre. Koha është e shkurtër prandaj duhet vepruar menjëherë. Konkretisht, deri më datë 4 Maj 2011 (d.m.th sot ishte dita e fundit) partitë politike duhet të paraqitnin propozimet e tyre për personat që do të përfshihen në këto komisione, ndërsa dy ditë para zgjedhjeve këto grupe duhet të jenë ngritur nga KZAZ-të. Duke marrë shkas nga problematikat e evidentuara nga zgjedhjet e kaluara, mendojmë se duhet ti kushtohet një rëndësie të madhe trajnimit të duhur të anëtarëve të grupeve të numërimit, me qëllim administrim sa më mirë të procesit të numërimit. Nuk ishte në objektin e vëzhgimit të KSHH-së monitorimi i dokumentacionit të anëtarëve të KZAZ-ve, të QV-ve dhe grupeve të numërimit, nëse ata plotësonin ose jo

⁷ Shih deklaratën e KSHH-së: “Ende nuk janë ngritur Komisionet e Qëndrave të Votimit (KQV-së)”, datë 22.04.2011



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kushtet dhe kriteret që kërkon ligji por, vonesa në propozimet për këto komisione dhe nxitimi për krijimin e tyre nuk përjashton mundësinë e mangësive në raport me ligjin. Pjesmarja në këto komisione sipas përkatësisë gjinore rezulton të mos jetë respektuar.

15. KShH pjesërisht ka monitoruar edhe funksionimin e KQZ-së : Në raportin e OSBE/ODIHR-it të 14 Shtatorit 2009, KQZ-ja veç të tjerave është kritikuar për politizim dhe njëanshmëri, ndarje sipas linjave partiake mazhorancë/opozitë. Siç duket, edhe në kuadër të këtyre zgjedhjeve, vazhdon e njëjta situatë, ndarje sipas linjave partiake, miratim i disa vendimeve të rëndësishme vetëm me 4 vota, madje midis tyre ka edhe akte normative, të cilat sipas ligjit duheshin miratuar me të paktën 5 vota të anëtarëve të KQZ. Në një rast të tillë, para disa ditëve ka reaguuar publikisht edhe KShH⁸. Përmendim gjithashtu, se në dt. 02/05/2011, Kolegji Zgjedhor, prishi edhe vendimin e miratuar me 4 vota të KQZ-së, që detyronte TV-të të pranonin kasetat filmike të subjekteve zgjedhore, gjë që jo vetëm cënonte lirinë e medias por, ishte dhe një tejkalim i kompetencës së KQZ. Po në këtë datë, Kolegji Zgjedhor, shfuqizoi pjesërisht edhe vendimin e KQZ-së lidhur me caktimin e disa qendrave të votimit në lokale private.

Roli i KQZ-së, siç dihet është i rëndësishëm. Mosbesimi ndaj veprimtarisë së tij, vendimmarrja e njëanshme dhe pa konsensus, nëse do të thelloheshin në të ardhmen mund të ndikonin negativisht në shqyrtimin e ankesave dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare. Le të shpresojmë se nuk do të ndodhë kështu. KShH mendon se si në procesin e votimit edhe në atë të numërimit të votave, subjektet zgjedhore nuk duhet të ndërhyjnë në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore, gjë që është vërejtur thuajse në të gjitha zgjedhjet.

16. Sipas njoftimeve të shtypit dhe vëzhguesve tanë, KQZ-ja ka vendosur prodhimin e një numri të madh vulash të Qendrave të Votimit me arsyetimin se ditën e votimit, anëtarë të këtyre komisioneve mund të braktisin qëllimisht detyrën dhe të marrin me vete edhe vulën. Megjithëse, deri më sot, nuk patëm mundësi të njihemi me përmbajtjen e plotë dhe zyrtare të këtij vendimi, në parim ne shprehim rezervat tona lidhur me ligjëshmërinë e tij. Për më tepër, ky vendim nuk mbështetet në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor. Kjo do të thotë se nuk ka dispozitë që të autorizojë KQZ-në të prodhojë vula tej nevojës që ka procesi zgjedhor. Veç kësaj, ne mendojmë se vendime të tilla ndikojnë negativisht dhe paragjykojnë veprime masive të kundraligjshme që kanë të bëjnë me ecurinë normale të procesit zgjedhor. Vlen të përmendet se në Kodin Zgjedhor (në nenin 170) është parashikuar

⁸ Shih deklaratën “Të respektohet liria e medias”, datë 27 prill 2011



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rasti i braktisjes së detyrës pa shkaqe të ligjshme nga anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve dhe anëtarët e Grupeve të numërimit, gjë që përbën kundravajte penale dhe dënohet deri në dy vjet heqje lirie. KQZ nuk mund të marrë rolin e legjislatorit dhe të krijojë norma që japin zgjidhje tej atyre që parashikon Kodi Zgjedhor. Një sjellje e tillë e vendos KQZ në konflikt kompetencash me organin legjislativ.

17. **Lidhur me arritjen e standarteve që kërkohen** : Nuk do të dëshironim të paragjykojmë jo vetëm për faktin se vëzhgimi jonë i deritanishëm është i pjesshëm dhe jo i plotë, por edhe për faktin se faza e votimit dhe e numërimit të votave mendojmë se janë të një rëndësie të veçantë dhe si rrjedhim deçizive për procesin zgjedhor. Megjithatë, të dhënat e deritanishme nuk të bëjnë të jesh tepër optimist për sa i përket plotësimit të standarteve demokratike për zgjedhje të lira e të drejta. E themi këtë, sepse edhe në këto zgjedhje, vërehen disa fenomene negative të ngjashme me ato që janë evidentuar në raportin e OSBE/ODIHR-it të 14 Shtatorit 2009. Kështu psh, pasaktësitë apo mungesat në listat e zgjedhësve (madje në këto zgjedhje pretendimet janë më të shumta) ; detyrimi i disa drejtuesve të disa shkollave mbi mësuesit e nxënësit për të dalë në mitingje, duke ndërprerë programin mësimor ; presione ndaj punonjësve të administratës shtetërore në lidhje me pjesëmarrjen në mitingje ose për të kufizuar lirinë e votës ; ndërhyrjet në privacinë e shtetasve nëpërmjet mesazheve në celular ose me mesazhe në internet etj. Veç kësaj, siç u tha edhe më lart, u vërtetuan vonesa nga partitë politike, jo vetëm në propozimet për KZAZ-të, por sidomos në propozimet për ngritjen e KQV-ve. Pavarësisht nga vullneti politik i partive (subjekte zgjedhore), që natyrisht është i rëndësishëm, vonesat në ngritjen e KQV-ve dhe të grupeve të numërimit të votave, mund të shoqërohen me pasoja që të çojnë deri në shkeljen e Kodit Zgjedhor ose të bllokimit të proceseve. Në këtë drejtim, siç u tha më lart, mund të ndikonte edhe mungesa e trajnimit ose e trajnimeve formale.